

Do ta filloja me një referencë nga eposi shqiptar, me një shembull që më duket mjaft domethënës, përveçse i stërnjohur në Shqipëri, siç është legjenda e Gjergj Elez Alisë. Është rrëfenja e dyluftimit ndërmjet një kreshniku vendas dhe armikut të tij, të emërtuar “Bajlozi Katallan”. Ky është një përbindësh gjigand, i zi dhe me një sy. Këtu shohim substratin arkaik të Odisesë, konkretisht personazhin e Polifemit. Por shohim edhe elementin historik të mitologjizuar, që përbën bërthamën e legjendës: dyndjen dhe inkursionet e katalanëve drejt Ballkanit në mesjetën e vonë. Treguesit janë vetë emërtimi i përbindshit, sistemi feudal perëndimor i taksave, me një enumeracion çuditërisht realist në këtë legjendë, madje edhe ngjyra e zezë e Bajlozit Katallan, siç lyheshin mercenarët *almogavares* të Roger de Flor-it për të frikësuar kundërshtarët. Porse elementi më i rëndësishëm, që përftohet në mënyrë ndërtekstuale me ngarkesën e një simbolizmi negativ - dhe aty qëndron arsyeja e referencës, - është ai i detit. Përbindshi, armiku, më tepër sesa vjen nga deti, *del* prej detit, gati-gati është i njësuar me detin. Më duket i rëndësishëm ky element ngase, ndërtekstualisht, e hasim shpesh në poezinë popullore shqiptare, si një konstante e saj në raport antonimie me malin. Në një varg semiotik gjithësesi të thjeshtuar, siç janë kodifikimet e mitologemave, deti përqaset me rrezikun, që tekefundit është rreziku nga kontakti me tjetrin, nga kontakti si konflikt, ndërsa mali, në një varg paralel dhe të përkundërt, ka kuptimin e mbrojtjes, të sigurisë së të qenit i vetëmbyllur. Nuk është e rastit që kjo antonimi spikatet sidomos në komentet mbi folklorin gjatë periudhës së një diktature që synonte ta izolonte vendin totalisht. Ndërkaq, më gjerë sesa ky shndërrim i mitologjisë në ideologji totalitare, antonimia e lartpërmendur reflektohet në vetidentifikimin si ballkanas përkundrejt harrimit të përkatësisë në Mesdhe.

Referenca tjetër e imja është nga përvoja vetiake. Prej vitesh jetoj në Barcelonë, pra në skajin tjetër të Mesdheut, ndonëse nuk kam shkuar atje me ato qëllime për të cilat Bajlozi Katallan erdhi në viset shqiptare. Mund të them se aty zbulova komponenten mesdhetare të identitetit tim, identitet i shumëfishtë, kuptohet, sikurse i çdo individi. Dua të theksoj se kjo komponente u bë e dukshme për mua si përbashkësi nëpërmjet kontrastit: komponente e përbashkët me njerëzit e qytetit ku jetoj, në kontrast me aspektet e tjera të identitetit, që i kemi të ndryshme - Shqipëria dhe Spanja (ose Katalonja), Gadishulli Ballkanik dhe Gadishulli Iberik, Europa Lindore dhe Europa Perëndimore, etj.

Sidoqoftë, nëse po flas për një vetëzbulim të identitetit mesdhetar në

Barcelonë, s'e kam fjalën tek asgjë konkrete, e identifikueshme. Arkitektura? Gastronomia? Stili i të veshurit? Mënyra e jetesës? Asgjë e tillë... ose ndoshta diçka e tillë, po nëpërmjet perceptimit vetiak, si diçka subjektive, si ndjesi e një atmosfere lidhur me këto që përmenda - shprehje e papërcaktueshme natyrisht, ku bën pjesë edhe ndjesia e mënyrës së komunikimit apo e humorit, të gjitha këto nën një prizëm subjektiv.

Këtu vijmë te çështja e identitetit mesdhetar si identitet kulturor. Mendoj se për të, ashtu sikurse për çdo identitet kulturor, nuk mund të flitet në kuptimin e një esence të pranishme në shpirtin e çdo *homo mediterraneus*, ose të karakteristikave shpirtërore të katalogueshme. Nëse ekziston një katalogim i tillë, atë e gjejmë vetëm në studime të psikologjisë sociale mbi formimin e stereotipeve e të paragjytimeve. Nga ana tjetër, mendoj se ka kuptim të flitet për identitet kulturor mesdhetar për aq sa e pranojmë realitetin e konstruktiveve socio-historike, një realitet sado jo objektiv sipas konceptit klasik të shkencave natyrore, të huazuar deri vonë edhe nga shkencat humane. Për ta qartësuar këtë ide, le ta përqasim kulturën me arketipin, enën apo strukturën primordiale ku, sipas Jung-ut, derdhen e marrin trajta përvojat e ndryshme jetësore. Kultura nuk ka të bëjë me arketipet psikike e të trashëgueshme të Jung-ut, por mund të themi se ka të bëjë me arketipet e Frederick Jameson-it, forma kulturore sociologjike dhe historikisht të kondicionuara. Pra, sociologjikisht - si përftesë ndërpersonale, dhe historikisht - si diçka në ndryshim dhe rikrijim të vazhdueshëm. Një parantezë e shkurtër: nuk kam parasysh historinë e parashikueshme në mënyrë logjike siç e postulon filozofia hegeliane, kjo ngrehinë sa madhështore, aq edhe e papërdorshme, që më kujton "Qytetin e të pavdekshmëve" të Borges-it.

Atëherë, çfarë kuptoj me identitet kulturor mesdhetar?

Për mua është, njëherësh, njësi dhe diversitet.

Diversiteti në Mesdhe është ndoshta karakteristika më e rrokshme. Shkrimtari kroat Predrag Matvejević e përkufizon Mesdheun si një mozaik, pra një diversitet që mund të vështrohet si një e tërë. Le të ndalemi te togfjalëshi "mund të vështrohet", për të rrokur tërësinë, apo njësinë. Është një togfjalësh që ngërthen perceptimin, subjektivitetin. Ashtu sikurse në sociologji, apo më gjerë në shkencat humane, faktet, që në të vërtetë janë akte, nuk mund të merren shkëputurazi nga subjektiviteti, - edhe realiteti i Mesdheut nuk mund të merret shkëputurazi nga ligjërimi rreth tij, siç thotë Predrag Matvejević në librin e vet "Breviarium i Mesdheut".

Njësia kulturore mesdhetare, pra, është diçka as thjesht objektive, as thjesht subjektive, sepse është diçka që i përket imagjinatës - një botë imagjinare që, natyrisht, nuk është vetëm e imja. Në kohët e lashta, kur Mesdheu ishte rajoni më i zhvilluar, aty ekzistonte përfytyrimi mitik mbi Atlantidën e zhdukur. Sot, në një kohë që rajoni më i zhvilluar është ai që fillon e shtrihet në të dy brigjet

mes të cilëve dikur përfytyrohej Atlantida, kemi një inversion rolesh, ndërsa Mesdheu i antikitetit klasik dhe i Rilindjes Europiane mund të përfytyrohet si njëfarë Atlantide e zhdukur.

Njësinë e Mesdheut do ta personifikoja me anë të dy figurave, nga këto dy epoka që sapo i përmenda. E para është ajo e Uliksit. Sipas hulumtuesve të mëvonshëm, itinerari i tij na shpie pothuajse në të gjitha brigjet dhe koordinatat e Mesdheut. Po më e rëndësishmja është se na shpie mendërisht në themelet homerike të poezisë. Figura tjetër është një piktor i shekullit XVI, Domenikos Teotokopulos, i cili nga Greqia shkoi në Venedik dhe mandej në Spanjë, ku e mbiquajtën El Greco. Në të dyja këto rrugëtime shembëllehet simbolikisht ideja se Mesdheu, si në njërën epokë, edhe në tjetrën, ishte një *orbis*, një botë, veçse nga këndvështrimi i sotëm. Dhe, si i tillë, ai ishte djepi i kulturës apo i qytetërimit tonë, i poezisë dhe i filozofisë, i arteve dhe i humanizmit. Tjetër çështje nëse Uliksit iu desh të luftonte me gjithëfarë përbindshash dhe nëse El Greco përfundoi në gjyqin e Inkuizicionit dhe pastaj në çmendinë.

Po në epokën e sotme? Në epokën e sotme, të ashtuqujtur “post-moderne” (etiketë paksa e vjetëruar kjo tashmë, siç vjetërohen me shpejtësi etiketat në ditët tona), personifikimi është i pamundur. Njeriu konceptohet si një rezultante faktorësh determinues të pakontrollueshëm nga uni i tij, si një paralelogram forcash sociale, ekonomike apo genetike, dhe shfaqet si i privuar nga mëvetësia e të menduarit të arsyeshëm dhe e zgjedhjes së lirë të moralshme. Ndërsa Mesdheu, me një tufë sistemesh diktatoriale, komuniste apo fashiste, në njëqind vjetët e fundit, me luftra ndëretnike, terrorizëm shtetëror ose joshetëror, dyndje refugjatësh që mbyten ngushticave të Otrantos apo të Gjibraltarit, brigjeve të Lampeduzës apo të Lesbosit, në çerekshekullin e fundit dhe deri në ditët e fundit, nuk i përngjan aspak përfytyrimit mbi djepin e kulturës.

Megjithatë, mendoj se këtij përfytyrimi, dhe traditës humaniste që ai përmban, ia vlen t’u rikthehemi. Duke vazhduar të besoj në mënyrë të pandreqshme në idetë e iluminizmit, mbi të cilat ngrihen shoqëritë e botës euroatlantike, të “Atlantidës së re”, mendoj se edukimi me vlerat që lindën në *mare nostrum* do të ishte i dobishëm, përkundër tmerreve që i jetojmë ose që i mësojmë çdo ditë nga mediat. Siç thoshte Charles Péguy, Homeri është më aktual se gazeta e djeshme. Dhe mund të shtohet se komunikimi, përkundër mbylljes e urrejtjes, do të ndihmonte në promovimin dhe riaktualizimin e atyre vlerave. Madje, nga komunikimi duhet filluar, që Mesdheu sërishmi të jetë *mare nostrum*.

Abstract

The Mediterranean region has traditionally been home to many cultures and civilisations. Living here has meant to act and interact with populations and nations.

Writer Bashkim Shehu deals in his article with the past and present situation of the Mediterranean culture and civilisations, paying special attention to the difference in the messages that they sent across in the past and at present. Shehu believes that Mediterranean culture resembles a mosaic where each tile plays a key role and forms part of the whole artwork. The author believes that the real challenge of the present day for the Mediterranean, however, is the transformation of the cultural and social landscape of the countries that constitute such culture.